

20231993509

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE

#### Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe „ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” nr.101/19, 153/19,180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21, 150/22 dhe 236/22), në nenin 104 paragrafin (2) në pikën 3) fjalët: „ose studime akademike të kryera“ shlyhen.

#### Neni 2

Në nenin 105 paragrafi (2) pika 3) ndryshohet si vijon:

“të ketë të përfunduar arsimin e lartë në fushën e shkencave medicinale, stomatologjike ose farmaceutike, arsim të lartë - logoped i diplomuar, arsim të lartë - specialist në biokimi mjekësore me të paktën 240 SETK, përkatësisht të paktën niveli VI A në përputhje me Kornizën Nacionale të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë;”.

#### Neni 3

Në nenin 110 paragrafi (11) ndryshohet siç vijon:

„Ushtrues i detyrës drejtor emërohet personi që i plotëson kushtet nga neni 104 paragrafi (2) të këtij ligji, përveç kushteve të pikave 5) dhe 6).”.

#### Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.